

Asnjë punë nuk është aq e rëndësishme sa të rrezikojmë jetën tonë për atë.

Stop në rast rreziku - të evitohet rreziku - të vazhdohet puna

Si bashkëpunëtorë të firmës

ne kemi detyrën të mbështesim eprorët tanë në zbatimin e masave për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit. Për vende pune të sigurta ne japim kontributin si në vijim:

1. Ne i lejojmë eprorët tanë të na informojnë për rregullat e sigurisë dhe për udhëzimet e punës të ndërmarrjes dhe i zbatojmë ato.
2. Ne e japim një kontribut aktiv për vende pune të sigurta në ndërmarrje. Nëse shohim mundësi përmirësimi, ne e vëmë eprorin tonë ose përgjegjës të sigurisë në dijeni për këto.
3. Në punën tonë kujdesemi, që të mos vëmë as vetveten as persona të tjerë në rrezik.
4. Ne nuk manipulojmë ose ndryshojmë në asnjë mënyrë pajisjet ekzistuese të mbrojtjes si skela, rrethime etj.
5. Ne i sigurojmë vendet tona të punës, menjëherë riparojmë mungesa ose i lajmërojmë eprorët tanë për ato.
6. Në raste të mungesave të rënda të sigurisë, veçanërisht nëse nuk zbatohen rregullat me rëndësinë për jetën, ne themi menjëherë STOP dhe e ndërpresim punën tonë menjëherë. Ne i informojmë kolegët dhe eprorët tanë pa asnjë vonesë.